

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa, Nesrin Lushta, Emine Kaçiku dhe Nebojsa Boriçiq anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Arben Ismajli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N. Q., nga fshati S., komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vrasje nga neni 146 të KPK, lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 pika 2 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarit N. Q., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr. 37/2011 datë 27.10.2011, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, më datë 21 mars 2012, mori këtë:

## A K T V E N D I M

Me rastin e ankesave të mbrojtësve të të akuzuarit N. Q., sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr. 37/2011 datë 27.10.2011, anulohet dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit, tani për tani ngelin jo lëndore.

Kundër të akuzuarit N. Q. vazhdohet paraburgimi.

## A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prizren, me aktgjykimin P.nr. 37/2011 datë 27.10.2011, të akuzuarin N. Q. e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale vrasje nga neni 146 të KPK, lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 pika 2 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK dhe për këto vepra penale i ka përcaktuar dënimet dhe atë: për veprën penale nga pika I të dispozitivit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh, për veprën penale nën pikën II të dispozitivit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh ndërsa për veprën penale nën pikën III të dispozitivit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh dhe me aplikimin e dispozitës së nenit 71 të KPK e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 05.05.2010 e tutje. Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues sekuestrim i armës automatike PSS prodhim i BRSS e kal. 7.62x25 mm me nr.serik 2093998 si

mjet i kryerjes së veprës penale. E ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 1.000 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit, N. T. dhe Z. T., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kanë ushtruar:

-mbrojtësi i të akuzuarit N. Q., I. K., avokat nga Prizreni, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza sepse veprimet i ka ndërmarr në kufijtë e mbrojtjes se nevojshme dhe përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim dukshëm më i butë, apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim,

-mbrojtësja e të akuzuarit N. Q., K. K., avokate nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza konform dispozitës së nenit 8 të KPK ose të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në seancën e kolegjit të shkallës së dytë prezent ishin mbrojtësit e të akuzuarit avokatët I. K. dhe K. K. si dhe i akuzuari N. Q., ndërsa Prokurori i Shtetit nuk ishte prezent edhe pse i njoftuar me rregull, mirëpo me parashtrësën PPA.nr. 24/2012 datë 26.01.2012, ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në seancë, pas shqyrtimit të shkresave të çështjes bashkë me ankesat e paraqitura dhe pasi aktgjykimi i ankimuar u studiua sipas detyrës zyrtare konform nenit 415 të KPPK, u gjet se i njëjti është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par. 1 pika 1 të KPPK, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset detyrimisht.

Aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga dispozita e nenit 403 par. 1 pika 1 të KPPK, sepse përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë në pajtim me ligjin.

Siç del nga shkresat e çështjes-procesverbali, seanca e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale ka filluar më 21 mars 2011 në këtë përbërje të trupit gjykues: gjyqëtari Xhevdet Elshani - kryetar, Lulzim Paçarizi-gjyqëtar profesionist dhe gjyqëtarëve laik Shyqri Shehu, Arife Begaj dhe Aziz Karaabo- anëtarë. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor e datës 26.08.2011

trupi gjykues ka pësuar ndryshimin ashtu që anëtari i trupit gjykues-Shyqri Shehu, është zëvendësuar me një anëtar tjetër gjyqtarin laik Fetah Kelmendi, i cili nuk ka marrë pjesë gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar në kundërshtim me dispozitën e nenit 345 të KPPK, e cila dispozitë parashikon se kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor fillon rishtas. Në rastin konkret, siç rezulton nga shkresat e çështjes shqyrtimi gjyqësor nuk ka filluar rishtas por, ka vazhduar me trup tjetër gjykues i cili nuk ka qenë në përbërje sipas ligjit, gjë që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës nga neni 403 par. 1 pika 1 të KPPK, shkelje kjo e cila u konstatua sipas detyrës zyrtare.

Nga arsyet e sipër cekura aktgjykimi u deshtë të anulohet, pa i vlerësuar pretendimet tjera ankimore, të cilat gjykata e shkallës së parë me rastin e rivendosjes duhet t'i merr parasysh dhe t'i vlerësoi. Në rigjykim duhet të mënjanohet shkelja e theksuar më lartë edhe një herë të vlerësohen të gjitha provat e propozuara në pajtim me dispozitën e nenit 387 të KPPK e më pas të merret vendimi i ligjshëm.

Meqenëse aktgjykimi u anulua për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat shkelje kjo Gjykatë kujdeset detyrimisht, ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit tani për tani janë jo lëndore.

Gjykata Supreme, vlerësoi edhe çështjen e paraburgimit ndaj të akuzuarit konform nenit 424 par 6 të KPPK dhe konstatoi se shkaqet ligjore, për të cilat paraburgimi ka qenë i vazhduar pas shpalljes së aktgjykimit akoma ekzistojnë.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 424 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË**  
Ap.nr.24/2012, më 21 mars 2012

Procesmbajtësi,  
Arben Ismajli

Anëtarët e kolegjit,

Kryetari i kolegjit,  
Avdi Dinaj

1. \_\_\_\_\_

Emine Mustafa

2. \_\_\_\_\_

Nesrin Lushta

3. \_\_\_\_\_

Emine Kaçiku

4. \_\_\_\_\_

Nebijsha Boriçiq